



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS LIPJAN

Numri i lëndës: 2023:064246

Datë: 28.08.2024

Numri i dokumentit: 06096710

P.nr.189/23

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA NË LIPJAN, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni penal, në përbërje prej gjyqtarit të vetëm gjykues Avdirrahman Gashi, me pjesmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Vesa Bajrami, në çështjen penale ndaj të pandehurit M. D. nga fsh. Sh. K. L., te cilin e mbron Arian Hetemi av. ne Lipjan, të cilin e akuzon PTH në Prishtinë, me aktakuzën e saj PP/II.nr.1786/23 të dt.21.03.2023, për shkak të vepres penale Mbajtja në pronësi, kontroll apo posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, në shqyrtimin fillestar, publik, të mbajtur me datën 28.08.2024, në prani të prokurores se shtetit Nebahate Salihi, të pandehurit dhe mbrojtësit te tij në të njëjtën ditë, mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

Kundër të pandehurit:

M. D., nga i ati A. dhe nëna S., e vajzërisë K., i lindur më ..., në fshatin Sh., me vendbanim në rrugën "B. S." në fshatin Sh. komuna e L., ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes të mesme ekonomike, me profesion Gastronom, i punësuar V. D.-L., i martuar, prind i tre fëmijëve, me numër personal, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R

S E P S E

Nga data e pacaktuar e deri me datën 05.11.2023 rreth orës 09:15 minuta, i pandehuri në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm për armët, e ka mbajtur në posedim në mënyrë të paautorizuar armë zjarri një pistoletë e tipit ..., kalibrit ...mm, me numër serik ..., një karikator me pesë fishekë, me mbishkrimin në bazë ...mm TT, ku gjatë bastisjes për një vepër tjetër penale ku i dyshuar ishte djali i tij dhe atë në shtepinë e tij e cila ndodhet në fshatin Shalë, të pandehurit i është gjetur në posedim arma e cila i është konfiskuar nga Policia,-

-me këtë ka kryer veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 paragrafi 1 të KPRK-së.

Andaj gjykata në bazë të dispozitave të lartëcekura si dhe dispozitave të neneve 1, 2, 4, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 43, 69 dhe nenit 366 par.1 të KPRK-së, si dhe nenit 364 të KPPK-së, të pandehurin e gjykon me:

DËNIM ME GJOBË

Me dënim me gjobë në shumë prej 500-€ (pesëqindeuro) i cili dënim do të ekzekutohet pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në rast se dënimi nuk realizohet as me detyrim, gjykata dënimit me gjobë do ta zëvendësojë konfrom nenit 43 par.3 të KPRK-së, ashtu që për çdo ditë të kaluar në burg, të llogaritet shuma prej 20-€.

DETYROHET i pandehuri që kësaj gjykate, në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të ia paguaj shumën prej 30-€ dhe shumën prej 20-€, në Fondin e Viktimave të krimit, këto në afat prej 15 dite pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

URDHËROHET konfiskimi i armës së zjarrit e pistoletë e tipit ..., kalibrit .. mm, me numër serik ..., një karikator me pesë fishekë, me mbishkrimin në bazë ... TT të sekuestruar nga ana e Policisë së Kosovës, dhe Detyrohet Policia e Kosovës – Stacioni Policor në Lipjan, që sendet e konfiskuara nese jane te papërdorshme të asgjësohen dhe nëse janë në gjendje të rregullt dhe funksionale te kalojnë në pronësi të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë, me aktakuzën e saj e ka akuzuar te pandehurin M. D. nga fsh. Sh. K. L., me aktakuzën e saj PP/IL.nr.1786/23 të dt.21.03.2023, për shkak të veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll apo posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së.

I pandehuri në seancën fillestare ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë dhe njeherit ka shtuar se është penduar për veprën penale të kryer, i ka premtuar gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsërisë vepra të tilla, dhe nuk ka qenë në dijeni se thika që ka qenë e ndaluar, është hera e parë që ka ra ndesh me ligjin i ka propozuar gjykatës që ti shqiptoj një dënim sa më të but.

Prokurorja e shtetit me rastin e pranimit të fajësisë nga ana e te pandehurit ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e te pandehurit, sepse ky pranim i fajësisë ka mbështetje në shkresat e lëndës si dhe bazë ligjore në dispozitat e KPPK-së i ka propozuar gjykatës që ta pranoj pranimin e fajësisë dhe të njëjtit ti shqiptoj një dënim konform dispozitave ligjore.

Mbrojtësja e të akuzuarit ka deklaruar se pajtohem me pranimin e fajësisë nga ana e te pandehurit pasi pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare si dhe pasi parapakisht ja ka shpjeguar benifitet që i parashef ligji, me rastin e pranimit të fajësisë, i ka propozuar gjykatës që ti ket parasysh rrethanat lehtësuese që i përmendi vetë i pandehuri si dhe faktin se i njëjti është i moshës së re që shihet nga ana e gjykatës dhe një person i sjellshëm që asnjëher më parë nuk ka pasur probleme me askënd dhe i ka premtuar gjykatës se kur probleme tjera nuk do të ket dhe siq shihet në gjykatë se është penduar që i ka ndodh i ka propozuar gjykatës që mundësisht ti shqiptoj një dënim sa më te but ose me kusht.

Gjyqtari i vetëm gjykues pasi është bindur se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, ky pranim i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare dhe pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësen e tij, pranimi i fajësisë nuk është rezultat i përdorimit të forcës, dhunës dhe premtimeve të kundërligjshme, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që i përmban aktakuza dhe se aktakuza nuk është e përfshirë në shkelje të qarta ligjore e as gabime faktike, konform nenit 242 të KPPK-së, e pranoi pranimin e fajësisë nga ana e te pandehurit për veprat penale për të cilat akuzohet.

Me rastin e vendosjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të pandehurin, gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe ato rënduese konform nenit 69 të KPRK-së, ashtu që prej rrethanave lehtësuese gjykata vlerësoi rrethanat para kryerjes së veprës penale, pra faktin se

i njëjti për herë të parë ka rënd ndesh me ligjin, rrethanat personale dhe familjare pra faktin se i njëjti është i moshës se re që len për të kuptuar se në të ardhmen do të behet antere i dobishem i shoqërisë dhe sjelljen pas kryerjes së veprës penale pra, faktin se i njëjti është përdorur për veprën penale dhe i ka premtuar gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsëritë sjellje të tilla, e veqanërisht pranimin e fajësisë, ndërsa në mungesë rrethanave rënduese dhe duke marr për bazë shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprave penale, të njëjtit i shqiptoi dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke qenë e bindur se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit konform nenit 47 të KPRK-së.

Vendimi për shpenzimet e procedurës u bazua në nenin 449 dhe 450 të KPPK-së, për paushall gjyqësor shuma prej 20-€, ndërsa shuma prej 20-€, u bazua në nenin 36 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimi për konfiskimin u bazua në nenin 366 par. 3 të KPRK-së.

Nga arsyet e cekura më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA NË LIPJAN

P.nr.189/23 dt.28.08.2024

Bashkëpunëtorja profesionale

Vesa Bajrami

GJYQTARI

Avdirrahman Gashi

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 30 ditë nga dita e dorëzimit të të njëjtit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.